



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/136
Datë: 10.03.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 10 mars 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti Vjetor i Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2016.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës për njoftim.
3. Autorizohet Sekretariati Koordinues i Qeverisë që Raportin nga pika 1. e këtij vendimi ta publikojë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në faqen e internetit të Zyrës së Kryeministrit.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/136
Datë: 10.03.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 10 mars 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2017 - 2021.
2. Buxheti për zbatimin e masave afatshkurtra dhe prioriteteve afatmesme në kuadër të këtij Programi mbetet brenda ndarjeve buxhetore të organizatave buxhetore për vitin 2017 dhe në pajtim me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Zyra e Kryeministrit, Ministria e Integritimit Evropian dhe institucionet tjera përgjegjëse, sipas Programit.
4. Obligohet Ministria e Integritimit Evropian të inkorporojë në Program të gjitha komentet e Komisionit Evropian.
5. Ministria e Integritimit Evropian obligohet që gjatë vitit 2017 të inkorporojë në Program veprimet pasuese të dalë nga konkluzionet e takimeve të raundit të parë të strukturave të Stabilizim-Asociimit të themeluara me MSA.
6. Këtë Program, obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që ta përcjellë për miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/136
Datë: 10.03.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 10 mars 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Propozim-vendimi për nisjen e procesit të planifikimit të IPA 2018-2020, me syqyerimin që gjatë këtij procesi të harmonizohen të gjitha çështjet ndërmjet ministrive përkatëse.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë edhe udhëzimet e Ministrisë së Integritit Evropian dhe kalendari i planifikimit të programeve IPA 2018-2020.
3. Ministria e Integritit Evropian obligohet që të ndërmarrë të gjitha hapat në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim të kryerjes së procesit për planifikimin e IPA 2018-2020.
4. Obligohen Institucionet përfituese nga IPA për periudhën 2018-2020 që të emërojnë zyrtarët e lartë për programim (ZLP) dhe të konfirmojnë emrat e tyre te Ministria e Integritit Evropian, brenda një afati dyjavor.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/136
Datë: 10.03.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe të Rregullores QRK Nr. 23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 10 mars 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Propozimi i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, lidhur me kërkesën e Komunës së Ferizajt për këmbimin e pronave të paluajtshme për ngastrat kadastrale me numër 10-0, vendi i quajtur "Shpellat" kulturë mal më sipërfaqe prej 125397m², zona kadastrale Mirosalë pronë e Komunës Ferizajt, dhe ngastrën kadastrale Nr.1149-0, vendi i quajtur "Shpellat" kulturë mal zona kadastrale Mirosalë pronë e Komunës së Ferizajt, me sipërfaqe prej 109944m² sipërfaqja e tërësishme 235341m², me ngastrat kadastrale Nr. 122-0 vendi i quajtur "Zhiva" në sipërfaqe prej 184295m², me kulturë mal i klasit të dytë, pasuri Shoqërore Ekonomia Pyjore Ferizaj, dhe ngastrën kadastrale Nr.123-0, vendi i quajtur "Zhiva" në sipërfaqe prej 10088m², me kulturë mal i klasit të dytë, pasuri Shoqërore Ekonomia Pyjore Ferizaj, sipërfaqja e tërësishme prej 194388 m², nën menaxhimin e Agjencisë Pyjore të Kosovës, për qëllim të realizimit të Projektit "Ndërtimi i varrezave të qytetit në Ferizaj".
2. Ky vendim bashkë me pjesët tabelare dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj, të përshkruar në pikën 1. të këtij vendimi.
3. Obligohet Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Komuna e Ferizajt dhe Institucionet tjera përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyrat kadastrale janë të obliguara të kryejnë veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
5. Vendimi hyn në fuqi pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë